




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr Prot. _____
Dep. <u>D.P</u>	Br Prot. _____
Dep. _____	Prot No. <u>01/3846/11</u>
Nr. i faq. _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>04.10.2011</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATË/A:</b>	03.10.2011
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-D.P.
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Ferid Agani – Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan Preteni – Drejtër i Agjencisë Kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>VENDIM</b> - lidhur me situatë konflikt interesi

I nderuar,

Ju shkruajmë këtu pas kërkesës tuaj drejtuar Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), të datës 26.08.2011, e pranuar me numër protokoli 03/3482/11, lidhur me sqarimin e situatës tuaj të mundshme për konflikt interesi, si Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës në njërën anë dhe si pronar i Ambulancës specialiste “Studio Agani” në anën tjetër .

Agjencia kundër korrupsionit, në kuadër të kompetencave të veta lidhur me konfliktin e interesit që ja jep Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Nr.04/L-051, neni 18, pika 12, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Nuk ka konflikt interesi** në situatën në të cilën gjendeni ju, (e përshkruar më lartë), bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (Nr.04/L-051).

Faqe 1 nga 1

**Arsyetimi:**

Gjatë hetimit dhe analizës së rastit tuaj, në kemi parë nga historia e biznesit nr.70461864 se ju me 11.08.2011 keni bërë transferimin e të drejtës së administrimit ose drejtimit të ndërmarrjes tuaj (Ambulanca specialiste “Studio Agani”) të një person i besuar (Muhamer Ahmeti). Me këtë veprim ju vet keni shmangur, paraprakisht, situatën konflikt interesi, në të kundërten, duke u bazuar në Ligjin për parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ajo situatë do të ishte konflikt interesi.

Neni 14 i Ligjit për Parandalimin e Konflikti të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) shprehimisht thot:

“ Çdo zyrtar i lartë , pronar i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t’i transferoj të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimit të ndërmarrjes te ndonjë person i besuar”.

Veprimin që ju e keni bërë në biznesin tuaj , duke transferuar të drejten e menaxhimit të personi i besuar, përkon pikërisht me këtë nen dhe konform kësaj baze ligjore, Agjencioni kundër korrupsionit ka dal me konstatimin e vet përmes këtij vendimi.

Me respekt,